



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 33, datë 25/2/2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI  
KËRKESAT PËR VLERËSIMIN DHE ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE  
QË LIDHEN ME SIGURINË NË SHERBIMET E TRAFIKUT AJROR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 78, pika 4, të Ligjit 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9658, datë 18.12.2006 për ratifikimin e “Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Mbi kërkesat për vlerësimin dhe zbatimin e ndryshimeve që lidhen me sigurinë në shërbimet e trafikut ajror”; sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Udhëzimi Nr.22, datë 16.10.2008 “Për Kërkesat dhe Kushtet për vënien në zbatim të Ndryshimeve tek Sistemet e MTA-së”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hym në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

Edmond Haxhinasto

## RREGULLORE

### MBI KËRKESAT PËR VLERËSIMIN DHE ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE QË LIDHEN ME SIGURINË NË SHERBIMET E TRAFIKUT AJROR

#### Neni 1

##### Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i sigurisë së vazhdueshme të shërbimeve si dhe vlerësimi i pavarur në mënyrë që:

- a) të gjitha ndryshimet në sistemet që përdoren për ofrimin e shërbimit të trafikut ajror janë vlerësuar nga ana e sigurisë;
- b) të gjitha rreziqet janë reduktuar para implementimit të çdo ndryshimi; dhe
- c) një vlerësim i tillë risku dhe zbutja, mbulojnë të tërë sistemet e menaxhimit të trafikut ajror gjatë gjithë jetëgjatësisë së atij sistemi.

#### Neni 2

##### Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (1) *'ndryshime që lidhen me sigurinë në shërbimin e trafikut ajror'* nënkupton të gjitha ndryshimet që ndikojnë në mënyrën e operimit, ndryshimet që prekin pjesërisht apo tërësisht sistemet, si dhe ndryshime të tjera, siç janë procedurat e kontrollit të trafikut ajror dhe inxhinierike, pajisjet, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe dokumentacionin shoqërues, apo ndryshimet organizative ose futja e standarteve të reja në aviacion. Këtu përfshihen edhe ndryshimet në sisteme si ai i ndriçimit apo i komunikimit tokë-tokë.
- (2) *'ndryshime madhore'* do të thotë një ndryshim që është përshkruar në pikën 1, i cili mund të paraqesë situata të rrezikshme të niveleve të Rrezikshmërisë 1 ose 2 (sipas Skemës së Klasifikimit të Rrezikshmërisë në Shtojcën B, pjesë integrale e kësaj rregulloreje) si dhe futja e standarteve të reja në aviacion.
- (3) *'ndryshime minore (të vogla)'* do të thotë një ndryshim që është përshkruar në pikën 1, i cili paraqet situata të rrezikshme të niveleve të Rrezikshmërisë 3, 4 ose 5 sipas Skemës së Klasifikimit të Rrezikshmërisë në Shtojcën B pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
- (4) *'AAC'* është shkurtim i përdorur për të identifikuar Autoritetin e Aviacionit Civil

Neni 3  
Detyrime për zbatimin

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë një procedurë të brendshme, e cila detajon të gjithë procesin e menaxhimit të një ndryshimi në mënyrë që të udhëzojë stafin që do merret me këtë proces.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore:
  - a) Duhet të hartojnë një procedurë të brendshme, e cila detajon të gjithë procesin e menaxhimit të një ndryshimi që do të zbatohet nga stafi përkatës. Kjo procedurë do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil,
  - b) Do të caktoj një pikë kontakti që do të mbledhë dhe raportojë të gjitha ndryshimet brenda afateve dhe siç kërkohet në këtë Rregullore.

Neni 4

**Autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e ndryshimeve**

Autoriteti i Aviacionit Civil është Autoriteti Kompetent për mbikëqyrjen e ndryshimeve.

Neni 5

**Njoftimi i Ndryshimeve**

1. Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të njoftojnë Autoritetin e Aviacionit Civil për të gjitha ndryshimet që planifikohen të kryhen.
2. Për të njoftuar ndryshimet pranë AAC-së, do të përdoret Formulari i Njoftimit të Ndryshimeve sipas shtojcës A, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 6

**Afatet e njoftimit të Ndryshimeve**

1. Për Ndryshimet Madhore, njoftimi pranë AAC duhet të kryhet që në fazën e planifikimit të ndryshimit, ose minimalisht 3(tre) muaj para datës së vënies në zbatim të ndryshimit.
2. Për Ndryshimet Minore, njoftimi pranë AAC duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e aplikueshme, ose minimalisht 15 ditë para datës së vënies në zbatim të ndryshimit.
3. Në rast se një ndryshim minor kërkon vënie në zbatim në mënyrë të menjëhershme, afati për njoftim do të jetë minimalisht 3(tre) ditë pas vënies në zbatim të ndryshimit.



## Neni 7

### Vlerësimi i Ndryshimeve

1. Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të kryejnë një vlerësim të ndryshimeve të planifikuara dhe në bazë të këtij vlerësimi duhet të bëjë një klasifikim të ndryshimeve në:
  - a) Ndryshime Madhore
  - b) Ndryshime Minore
2. Për të njëjtin ndryshim, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kryej një vlerësim tjetër të pavarur nga ai i Ofruesit të Shërbimit të Lundrimit Ajror apo nga palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore. Ky vlerësim ka prioritet nëse rezultatet e dy vlerësimeve nuk përputhen.

## Neni 8

### Ndryshimet Madhore

1. Për ndryshimet madhore, Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të dorëzojnë pranë AAC, bashkëngjitur Formularit të Njoftimit të Ndryshimit edhe:
  - a) Një koncept Operacional
  - b) Një plan tranzicional për vënien në zbatim të ndryshimit
  - c) Një Metodologji Vlerësimi Sigurie (sipas Eurocontrol-SAM ose ekuivalentin e tij) duke përfshirë:
    - metodën e identifikimit të situatës së rrezikshme,
    - identifikimin e vetë situatës së rrezikshme,
    - strategjinë e vlerësimit dhe zbutjes së rrezikut (Vlerësimin e Situatës Funktionale të Rrezikshme(FHA)),
    - Vlerësimi Paraprak i Sigurisë së Sistemit (PSSA),
    - Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit (SSA).
2. Autoriteti i Aviacionit Civil, pasi të ketë shqyrtuar të gjithë dokumentacionin, miraton dhe lejon kryerjen e Ndryshimit.
3. Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore nuk duhet të zbatojë asnjë ndryshim madhor pa marrë më parë pranimin nga AAC.
4. AAC, për të shqyrtuar sa më mirë një ndryshim të caktuar dhe në varësi të ndryshimit, mund të kërkojë informacione shtesë, të ndërmarrë inspektime apo auditime, si dhe mund të marrë pjesë gjatë procesit të testimeve të sistemit.
5. Në rast se AAC nuk kthen përgjigje lidhur me njoftimet e marra për ndryshim për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së njoftimit, Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, mund të nisin implementimin e ndryshimit dhe kryerja e këtij veprimi, konsiderohet e miratuar nga AAC.

## Neni 9

### **Ndryshimet Minore**

Ndryshimet Minore mund të zbatohen menjëherë nga Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror dhe palët që preken nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, pas njoftimit të AAC nëpërmjet Formularit të Njoftimit të Ndryshimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në përputhje me procedurat e miratuara nga AAC.

## Neni 10

### **Procedura speciale**

Në rastet kur një ndryshim, madhor apo minor, është subjekt edhe i ndonjë Rregulloreje tjetër, bashkangjitur dokumentacionit referuar më sipër do të kërkohet nga AAC edhe dokumentacioni që plotëson kërkesat e dala nga këto Rregullore.

## SHTOJCA A

### NJOFTIMI I NDRYSHIMEVE QË LIDHEN ME SIGURINË NË SHËRBIMIN E TRAFIKUT AJROR

Kur një Ofrues Shërbimesh ka qellim të iniciojë një ndryshim në sistemet e tij, duhet të plotësojë formën e mëposhtme:

#### FORMA E NJOFTIMIT TË NDRYSHIMIT<sup>1</sup>

IDENTIFIKIMI I NDRYSHIMIT
Ref. nr. dhe titullin

I. TË DHËNAT E ORGANIZATËS DHE PRANIMI				
Organizata				
Adresa				
Shërbimet/funksionet e ofruara	<input type="checkbox"/> ATS	<input type="checkbox"/> MET	<input type="checkbox"/> AIS	<input type="checkbox"/> CNS
	<input type="checkbox"/> ATFM	<input type="checkbox"/> ASM	<input type="checkbox"/> OTHER	
Data e certifikimit <sup>2</sup>				
Menaxheri i Sigurisë së Korporatës				
Telefon				
E-mail				
Pika e kontaktit për këtë ndryshim (nëse ka) <sup>3</sup>				
Funksioni				
Telefon				
E-Mail				
Data				
Menaxheri i Sigurisë së Organizatës nënshkrimi <sup>4</sup>				

<sup>1</sup> Te plotësohet dhe të dërgohet në Autoritetin Kombëtar të Mbikqyrjes për ndryshime në ofrimin e shërbimeve, të cilat mund të ndikojnë përputhshmerinë me kërkesat e përbashkëta ose me kushtet bashkëngjitur me certifikatën dhe ndryshimet e lidhura me sigurinë, ku shkalla e rrezikshmerisë është 1,2,3,4 ose 5. Referuar Urdhërit të Ministrit të Transporteve Nr. 115 datë 23.10.2012 "Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror", Shtojca II, për një përcaktim të shkallëve të rrezikshmerisë.

<sup>2</sup> Për subjektet që ofrojnë shërbime ATFM ose ASM, datën e pranimit të procedurave të tyre të ndryshuara.

<sup>3</sup> Pikat e Kontaktit, ose Menaxheri i Sigurisë së Korporatës, nëse nuk është emëruar PeK, do të mbahet i informuar për të gjitha shkëmbimet ndërmjet AKM/DMSHLA-së dhe organizatës.

## 2. PERMBLEDHJE E TE DHENAVE TE NDRYSHIMIT

Përshkrim i shkurtër i ndryshimit				
Arsyet për dhe rezultatet e pritshme të ndryshimit				
Lidhje me ndryshime të tjera				
Lidhje me AKM-te të tjera <sup>5</sup>				
A është i njoftuar ndryshimi i tanishëm, me parë?	<input type="checkbox"/> Jo			<input type="checkbox"/> Po
Nëse po, identifikoni ndryshimet e rëndësishme që në njoftimin e fundit				
Shërbimet/funksionet që ndikohen	<input type="checkbox"/> ATS	<input type="checkbox"/> MET	<input type="checkbox"/> AIS	<input type="checkbox"/> CNS
	<input type="checkbox"/> ATFM		<input type="checkbox"/> ASM	
Klasa e rrezikshmërisë së vlerësuar <sup>6</sup>	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4
	<input type="checkbox"/> 5		<input type="checkbox"/> E pacaktuar	
Faza e projektit aktual	<input type="checkbox"/> Përkufizimi nocionit		<input type="checkbox"/> Projektimi	
	<input type="checkbox"/> Zbatimi		<input type="checkbox"/> Hyrje në operim	
	<input type="checkbox"/> Operacional		<input type="checkbox"/> Mospranim	
	<input type="checkbox"/> Tjera:			
Data e pritshme për përfundimin/prezantimin në shërbim, të ndryshimit				

<sup>4</sup> Kopjet e shtypura të këtij formulari do të firmosen nga Menaxheri i Sigurisë së Korporatës. Versionet elektronike të pafirmosura, janë pranuar, me kusht që ato janë dërguar nga Menaxheri i Sigurisë së Korporatës.

<sup>5</sup> Për ndryshimet që ndikojnë në shërbimet nderkufitare, njoftimi i ndryshimit, do të paraqitet në të gjitha AKM-te përkatëse dhe ato paralele. Kjo pjesë do të identifikojë qartë të gjithë AKM-te, të cilat janë ose do të njoftohen në lidhje me ndryshimin.

<sup>6</sup> Për shkallët e rrezikshmërisë 1, 2 dhe 3, një dokument do të sigurohet nga aplikanti si një shtojcë që tregon se si shkalla e rrezikshmërisë është vlerësuar. Autoriteti i Aviacionit Civil rezervon të drejtën për të verifikuar se si shkallët e tjera të rrezikshmërisë janë përcaktuar, gjatë çdo aktiviteti në vazhdim e sipër. Çdo modifikim që del në vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë, mbi një ndryshim, do t'i komunikohet AKM-se, sa më shpejt që të jetë përcaktuar.



### 3. PERGJEGJESITE KRYESORE

Udhëheqësi i projektit i ngarkuar për menaxhimin e përgjithshëm të ndryshimit.	
Emri	
Departamenti/ njësia	
Telefon	
E-mail	
Menaxheri i sigurisë për ndryshimin (nëse ka) <sup>7</sup>	
Emri	
Departamenti/ Njësia	
Telefon	
E-mail	

<sup>7</sup> Personi që është përgjegjës për ofrimin e situatës së sigurisë dhe të gjithë aktivitetëve të lidhura me të.



## Materiale Udhëzuese – Forma e Njoftimit të Ndryshimit

### Të përgjithshme

Secilës prej pyetjeve në formular mund t'u jepet përgjigje në të njëjtën formë. Megjithatë, rekomandohet të ofrohen shtojcat përkatëse si dokumente të veçantë dhe të paraqitet një përmbledhje e shkurtër në dokument, së bashku me referencën e shtojcës së aplikuar (me detaje).

### Pjesa 1: Të dhënat e Organizimit dhe Pranimit

Kjo pjesë do të identifikojë organizatën që paraqet Njoftimin dhe Pikën e Kontaktit të organizatës.

### Pjesa 2. Përmbledhje e Të Dhënave të Ndryshuara

Kjo pjesë do të sigurojë një përmbledhje të ndryshimit të synuar. Gjithashtu do të konsiderohet edhe Informacioni si mëposhtë:

1. Përshkrim i shkurtër i ndryshimit i cili përfshin një përmbledhje të ndryshimit. Përshkrimi më i detajuar duhet të përfshihet në materialin bashkangjitur. Detajet mund të sigurohen përmes Përshkrimit të Konceptit Operacional, Specifikimet e Prokurimit etj.
2. Argument i cili shpjegon përfitimet që sjell ky ndryshim, veçanërisht për një ndryshim që ndikon në sigurinë.
3. Njoftim për të gjitha AKM-te e përfshira në vlerësimin e ndryshimit, nëse ndryshimi ndikon në sistemet e ATM-se që përdoren për ofrimin e shërbimit në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e dy ose më shumë AKM-ve.  
Në rastet kur marrëveshjet e tjera kanë qënë njoftuar nga OSHLA-ja, njoftimi do të dërgohet tek të gjitha AKM-te e përfshira dhe ky njoftim do të identifikojë AKM-te e tjera të përfshira në vlerësimin e ndryshimit. Në këtë rast, AKM-te sa më shpejt të jetë e mundur, do të koordinojnë rishikimet/vlerësimet me AKM-te e tjera, për të shmangur publikimin e punës.
4. Një përditësim i një vlerësimi të mëparshëm të një Sistemi të njëjtë ATM, kryer nga OSHLA-ja, mbi bazën e të cilit do të përcaktohet shkalla e vlerësuar e rrezikshmërisë.
5. Njoftim paraprak përpara planifikimit të ndryshimit për AKM nga OSHLA. P.sh OSHLA-ja njofton ndryshimet e planifikuara. Kjo mundëson AKM-ne të mbështesë OSHLA-ne në sigurimin e kërkesave, planeve, proceseve etj. të cilat plotësojnë informacionin e duhur për AKM-ne, që të arrijë një pranim.

### Pjesa 3: Përgjegjësitë Kryesore

Kjo pjesë do të ofrojë një identifikim të qartë të organizimit për zbatimin e ndryshimit, si dhe menaxherit të sigurisë së caktuar për të mbështetur zbatimin e këtij ndryshimi.

# SHTOJCA B

## SKEMA E KLASIFIKIMIT TË RREZIKSHMËRISË

			Probabiliteti për fluturime/ore				
			<i>S'ka objektiv</i>	<i>Objektiv 10<sup>-2</sup></i>	<i>Objektiv 10<sup>-4</sup></i>	<i>Objektiv 10<sup>-5</sup></i>	<i>Objektiv 10<sup>-8</sup></i>
Rreziqe			Çdo ditë	Një here në javë	Një here në muaj	Një herë në vit	Ka shumë mundësi mos të ndodhi asnjëherë- s'ka ndodhur asnjëherë deri tani gjatë kohës jetësore të sistemit
A s h  p ë r  s i a	Humbje totale e barrierave të Sigurisë	1	A1	A3	A6	B2	B4
	Humbje serioze e barrierave të Sigurisë	2	A2	A4	B1	C2	C6
	Humbje e madhe e barrierave të Sigurisë	3	A5	B3	C1	C5	D6
	Humbje e vogël e barrierave të Sigurisë	4	C3	C4	D1	D4	D7
	Efekt jo i drejtpërdrejt në Siguri	5	D2	D3	D5	D6	D8